



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 451/25 Datë: 22.04.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 136 të mbajtur më 14.04.2025, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohen programet e studimeve të Kolegjit Biznesi për periudhën tri (3) vjeçare, (1 tetor 2025 – 30 shtator 2028):
 - ***Juridik, LLB 240ECTS (R) me kuotë 50 studente***
 - ***Menaxhimi i emergjencave BA 180 ECTS (R) me kuotë 150 studente***
- II. Numri i studentëve vlen dhe zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Kolegji Biznesi që deri më datë 30.09.2025 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Kolegji Biznesi të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet vetëm me vendim nga KShC.
- V. Institucioni i Arsimit të Lartë si në paragrafin I mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Kolegji Biznesi brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Faqe 1 nga 3

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Juridik, LLB 240ECTS (R)</i>	Sedat Ismajli Muhamet Binaku Mitasin Beqiri Sejdafa Gjafqë Arben Agushi
2.	<i>Menaxhimi i emergjencave BA 180 ECTS (R)</i>	Faton Maloku Imerlije Alili Milazim Shabani Adem Musliu Atdhe Kabashi

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin Biznesi.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelori dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

Për programin e studimit; *Juridik, LLB 240ECTS (R)*, vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 24.02.2025 me këtë përbërje: Bertel De Groote, Dovile Gailiute-Janusone dhe Marija Vasilevska. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht një (1) fushë të standardeve të akreditimit
- Substancialisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit.
- Pjesërisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit.

Për programin e studimit; *Menaxhimi i emergjencave BA 180 ECTS (R)*, vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 26.02.2025 me këtë përbërje: Tornike Khoshtaria, Magdalena Iordache Platis dhe Katerina Klimoska. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht pesë (5) fusha të standardeve të akreditimit
- Substancialisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 136-të, të mbajtur më datë 14.04.2025, ka shqyrtuar dokumentacionin e Kolegjit Biznesi dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/1110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit Biznesi;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë